

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me kryetarin e trupit gjykues Musa Konxheli, bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen penale ndaj te pandehurit I.I. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.34/15 te dt. 4 gusht 2015, në praninë e Prokurorit të shtetit Shukri Jashari, të pandehurit I.I., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më dt.11.10.2016 sjell dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri: I.I., i biri i H. dhe nënës Xh. e vajzërisë M., data e lindjes..... në në, me vendbanim në Ferizaj rr”....., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka te kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me dt.04 Mars 2016, rreth ores 11.30 në rr.”....., me qëllim shitje ka poseduar pa autorizim substanceën e dyshuar narkotike të llojit marihuanë, në peshë 15.43 gr, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga ana e njësitit antidrogë, në oborrin e shtëpisë së të pandehurit, kanë gjetur edhe 6 qese me substancë narkotike të llojit marihuana, tri fara të bimës kanabis sativa, tre mullinj për bluarjen e marihuanës si dhe një peshore digjitale për matjem e narkotikëve, me çrast të njejtat konfiskohen përkohësisht nga policia,

me të cilën kreu veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat ligjore te neneve **3, 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 52, 73, 75, 76 par.1 nenpar.1.3 te KPRK-se dhe nenit 359 e 365 te KPPRK-se**

**AKTGJYKIM FAJESUES
G J Y K O N**

Te akuzuarin I.I.,

ME DËNIM BURGIMI: në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve** në të cilin llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga dt.04.03.2016 deri 06.03.2016 , I cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërise se ketij aktgjykimi si dhe **DENIM ME GJOBË** në shumën prej 200 euro.

Denimi i shqiptuar me gjobë, nuk do te ekzekutohet nese i pandehuri gjate periudhes verifikuese ne afat prej një viti nga plotefuqishmeria e ketij aktgjykimi nuk kryen veper penale tjeter te kesaj natyre

Konform nenit 273 par.5 të KPPRK-së, konfiskohen në mënyre te përhereshme: substanca narkotike e llojit marihuana me peshe 15.43 gr kg, të sekuestruar përkohesisht nga Policia e Kosoves.

URDHEROHET Policia e Kosoves qe pas plotëfuqishmërise së ketij aktgjykimi ta bëj shkatrrimin e substancave narkotike të llojit marihuana me peshe 15.43 gr të konfiskuara në mënyrë te përhereshme

I akuzuari I.I. obligohet që në emër të shpenzimeve ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30/tridhjetë/ euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktgjykimi.

Historiku i procedures

Prokuroria e Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.34/15 te dt.4 gusht 2015 e ka ngarkuar të pandehurin I.I. nga Ferizaj, për shkak te veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar gjyqësor më dt. 11.10.2016 në të cilin prokurori i shtetit Shukri Jashari në tërësi ka mbetur pranë akuzës duke i propozuar gjykatës që te pandehurin ta shpallë fajtor për vepër penale si qe janë përshkruar ne dispozitivin e aktakuzes dhe ti shqiptohet dënimi sipas ligjit.

I pandehuri I.I., në shqyrtimin fillestar gjyqësor e ka pranuar fajsinë me të cilën e ka ngarkuar akuza duke premtuar se ne te ardhmen asnjëherë nuk do te kryej vepra penale tjera apo te ngjashme.

Meqenëse i pandehuri I.I. ka pranuar fajësinë për vepren penale për të cilën e ngarkon aktakuza në të gjitha pikat e sajë, i cili pranim është në përputhje me kriteret e përcaktuara me neni 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues pasi paraprakisht ka marr edhe mendimin e prokurorit te shtetit, konform nenit 248 par.5 të KPPRK-së ka pranuar fajësinë e të pandehurit në shqyrtimin fillestar.

Analiza e ligjit material

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se ekzistojne elementet e vepres penale në veprimet e të pandehurit I.I. nga Ferizaj, per shkak te veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së

Kryerja e veprave penale nga i akuzuari vertetohet edhe nga provat tjera te propozuara nga prokurori I shtetit ne aktakuzen e cila eshte objekt shqyrtimi dhe ate:

Vertetimi mbi sekuestrimin e perkoheshem te sendeve I dt.04.03.2016, raporti I ekspertizes se AKF-se nr./2015-DHTN-037 dt.22.06.2015 si dhe fotografit qe gjenden ne shkresa te lendes.

Përcaktimi i dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 dhe 76 te KPRK-se. Sipas nenit 74 par.3 nenpar.3.10 dhe 3.11 te KPRK-se, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë, dhe keqardhjen te shfaqur nga i pandehuri. I njëjti pas kryerjes se kësaj veprë penale është penduar dhe është zotuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, Gjykata mori parasysh edhe llojin e narkotikut qe eshte gjetur tek i pandehurisi dhe sjelljen korrekte gjatë procedurës.

Si rrethana rënduese gjykata vlerësoi dashjen e të pandehurit, pastaj shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj në kuptim të gjitha këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi me dënim të pëcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi I cili dënim është në minimumin e paraparë ligjor, me të cilat dënime do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të nenit 41 të KPRK-së që të njëjtin ta parandalojë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe I ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 200 euro, I cili dënim nuk do te ekzekutohen nese i pandehuri gjate periudhes verifikuese ne afat prej një viti nga plotefuqishmeria e ketij aktgjykimi nuk kryen veper penale tjeter te kesaj natyre

Substancat narkotike të sekuestruar të konfiskohen në mënyre te përhereshme. Konform nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së, i akuzuari u obligua që në emër te shpenzimeve ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30/tredhjetë/ euro, në afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,
PKR.nr.144/15 dt. 11 Tetor 2016**

Bashkëpunëtore profesionale

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues

Musa Konxheli

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes kësaj gjykate.